

20071151503

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT
PËR MBROJTJEN E TRASHËGIMISË KULTURORE

Neni 1

Në Ligjin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 20/2004), në nenin 8 paragrafi (3), në fund të fjalisë fjalët në kllapa “të kinotekës”, zëvendësohet me fjalët: “për mbrojtjen e të mirave audiovizuele”.

Neni 2

Në nenin 9 paragrafi (2) fjalët: “të kinotekës” fshihen, ndërsa shtohen fjalët: “për mbrojtjen e të mirave audiovizuele”.

Neni 3

Në nenin 11 paragrafin (1) pas pikës 18, shtohen dy pika të reja 18-a dhe 18-b, si vijojnë:

“18-a “Përmbledhje publike” (koleksion) është përmbledhja që është në pronësi të shtetit ose të njësisë së vetadministrimit lokal, ose të institucionit që është pronë e tyre ose në pjesën më të madhe financohet prej tyre, dhe ka seli në territorin e shtetit.

18-b “Sende të koleksioneve” janë sendet që i kanë karakteristikat e duhura që të përfshihen në ndonjë koleksion, përkatësisht sendet që janë relativisht të rralla, nuk përdoren për dedikimin e tyre themelor, i nënshtrohen transaksioneve specifike jashtë tregtisë së zakonshme të sendeve me përdorim të ngjashëm dhe kanë vlerë të madhe;”.

Neni 4

Titulli para nenit 22 “Të mirat e kinotekës”, zëvendësohet me titullin “Të mirat audiovizuele”.

Neni 22 ndryshon, si vijon:

“(1) Të mira audiovizuele janë: materialet burimore dhe kopja e zërit të filmit artistik, dokumentar, të animuar, eksperimental dhe alternativ, si dhe vepra tjetër audiovizuele, e shprehur në formë të fotografive të lidhura lëvizëse me ose pa zë, pa dallim nga lloji i mbajtësit që i përmban, që janë të dedikuara për shfaqje publike.

(2) Të mira audiovizuele konsiderohen edhe materialet përcjellëse që kanë të bëjnë me fotografitë lëvizëse, siç janë dokumentacioni i shkruar, skenarët, librat për incizim, skicat skenografike dhe kostumografike, kostumet, rekuizitat skenografike, mikrofilmat, fotografitë, sllajdet, posterët dhe materiali tjetër propagandues, si dhe ekzemplari i detyrueshëm që dërgohet në institucionin kompetent amë”.

Neni 5

Pas nenit 32, shtohet neni i ri 32 – a si vijon:

“Pasuri nacionale”

Neni 32-a

(1) Pasuri nacionale sipas këtij ligji, marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare dhe dispozitave të Unionit Evropian, janë të mirat që i takojnë ndonjërit nga llojet e trashëgimisë së tundshme kulturore, nga nenet 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22 dhe 23 të këtij ligji, përkatësisht që paraqesin:

1. Sendet arkeologjike më të vjetra se 100 vjet, që rrjedhin nga hulumtimet dhe zbulimet tokësore ose nënujore, vendzbulimet arkeologjike dhe përmbledhjet arkeologjike;

2. Elementet që janë pjesë përbërëse të monumenteve artistike, historike ose religjioze, që kanë qenë të ndara dhe janë më të vjetra se 100 vjet;

3. Pikturat dhe punimet e piktorëve të ndryshme nga ato të përfshira në pikat 4 dhe 5 të këtij paragrafi, që në tërësi janë punuar me dorë, në çfarëdo teknike ose materiali, më të vjetra se 50 vjet;

4. Akuarelet, guashet dhe pastelet që në tërësi janë të punuara me dorë, në çfarëdo materiali, më të vjetra se 50 vjet;

5. Mozaikët nga të gjitha materialet të punuara me dorë, të ndryshme nga ato të përfshira në pikat 1 dhe 2 të këtij paragrafi, si dhe vizatimet e punuara në çfarëdo teknike ose materiali, më të vjetra se 50 vjet;

6. Gravurat, grafikat, serigrafitë dhe litografitë origjinale, me pllaka përkatëse dhe posterë origjinalë, më të vjetër se 50 vjet;

7. Skulpturat dhe bustet origjinale, dhe kopjet e punuara në procedurën e njëjtë si origjinali, përveç atyre të përfshira në pikën 1 të këtij paragrafi, më të vjetra se 50 vjet;

8. Fotografitë, filmat dhe negativët e tyre, dhe regjistrimet origjinale të zërit, më të vjetra se 50 vjet;

9. Inkunabulat dhe dorëshkrimet, si dhe hartat gjeografike dhe partiturat muzikore, veç e veç ose në përmbledhje, më të vjetra se 50 vjet;

10. Librat më të vjetra se 100 vjet, veç e veç ose në përmbledhje;

11. Hartat e botuara gjeografike, më të vjetra se 100 vjet;

12. Lënda arkivore ose çfarëdo pjese e saj, nga çfarëdo lloji ose mediumi, më të vjetra se 50 vjet;

13. Vizatimet, skicat dhe maketet arkitektonike, shkencore dhe inxhinierike, më të vjetra se 50 vjet;

14. Përmbledhjet numizmatike, filatelike, etnografike dhe historike, ose sendet e veçanta nga përmbledhjet e atilla, më të vjetra se 50 vjet;

15. Mjetet e transportit dhe pjesët e tyre, më të vjetra se 75 vjet;

16. Antikitete të tjera më të vjetra se 50 vjet, që nuk janë përfshirë në pikat 1-15 të këtij paragrafi (lojëra, sende prej qelqi, sende prej ari, argjendi, argjile dhe qeramike, mobile dhe prodhime të tjera prej druri, metali, instrumente muzikore, orë dhe pjesë të tyre, armët, municioni, eksplozivi dhe pajisja ushtarake, prodhime prej tekstili, uniforma, veshje, punime të qëndisura, qilima, tapiceri, pajisja optike, fotografike dhe filmike, veglat, makinat, instrumentet matëse, veglat ndihmëse arsimore, pajisja mjekësore, sendet teknike dhe zejtare dhe sende të tjera që nuk janë shënuar në mënyrë të veçantë);

(2) Të dhënat nga paragrafi (1) i këtij neni, konsiderohen si pasuri nacionale, nëse:

1) Janë të mbrojtura si trashëgimi kulturore me rëndësi të veçantë, ose janë të shpallura si trashëgimi kulturore me rëndësi;

2) Janë regjistruar në librin e inventarit, si pjesë e përmbledhjes publike, me të cilën udhëheq institucioni publik muzeor, i bibliotekës ose kinotekës ose Arkivi;

3) Paraqesin pjesë të pajisjes së objekteve të mbrojtura fetare, ose përmbledhje sakrale e mbrojtur, e bashkësisë së caktuar fetare;

4) Konfirmohet se kanë vlerë arkeologjike, historike, artistike ose vlerë tjetër kulturore ose shkencore për Republikën e Maqedonisë, për arsye se janë:

- vepër artisti, dizajnuesi ose krijuesi, që është me rëndësi për sferën e caktuar nga kultura në Republikën e Maqedonisë;

- prodhim i kreativitetit vendas, përkatësisht dijes;

- karakteristike nga aspekti i trashëgimisë kulturore nacionale;

- të lidhura me personin, dukurinë ose ngjarjen me rëndësi për historinë nacionale të Republikës së Maqedonisë dhe të bashkësive në Republikën e Maqedonisë;

- të lidhura me monument, tërësi monumentesh, rajon kulturor ose mjedis tjetër kulturor me rëndësi ose të mira folklorike, dhe
- të rralla, të rrezikuara ose do të bëhen të rralla në territorin e Republikës së Maqedonisë”.

Neni 6

Në nenin 40, paragrafi (3) pas fjalisë së parë shtohet fjali e re si vijon: “Nëse poseduesi nuk paraqet mendim në afat prej 15 ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës për mendim, konsiderohet se është dhënë mendim pozitiv.”

Neni 7

Pas nenit 42 shtohet neni i ri 42 – a, si vijon:

“Aktvendimi për përcaktimin e pasurisë nacionale”

Neni 42-a

(1) Aktvendimi për përcaktimin e pasurisë nacionale, merret në rastet nga neni 32-a paragrafi (2) pika 4 e këtij ligji, për antikitet dhe sende të tjera të koleksioneve, mbrojtja e të cilave nuk është konstatuar në mënyrë tjetër të përcaktuar me këtë ligj, kur ato janë:

- lëndë e kërkesës për eksport ose nxjerrje jashtë vendit;
- në mënyrë të paligjshme të dërguara nga territori i Republikës së Maqedonisë, dhe janë lëndë e restitucionit, përkatësisht kthimit;

(2) Aktvendimin nga paragrafi (1) i këtij neni, e miraton Drejtoria për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, me detyrë zyrtare ose me kërkesën e institucionit kompetent publik për mbrojtjen, përkatësisht personi juridik i autorizuar, për kryerjen e punëve të mbrojtjes së të mirave të fonotekës.

(3) Aktvendimi nga paragrafi (1) i këtij neni, e ka veprimin e aktit për shpalljen e trashëgimisë kulturore me rëndësi.

(4) Ankesa kundër aktvendimit për përcaktimin e pasurisë nacionale, nuk e ndalon zbatimin e aktvendimit.”

Neni 8

Në nenin 55, paragrafi (1) ndryshon si vijon:

“Me hulumtime arkeologjike sipas këtij ligji, nënkuptohen:

- gërmimet arkeologjike (gërmimi sistematik, gërmimi i mbrojtur dhe gërmimi i sondazhit);
- kontrolltet arkeologjike të terrenit (reambulacioni dhe rekognoscimi);
- metodat jodestruktive (aeroarkeologjia, hulumtimet gjeofizike dhe hulumtimet gjeoradare) dhe
- hulumtimet nënujore.”

Pas paragrafit (1) shtohet paragrafi i ri (2), si vijon:

(2) “Hulumtimet arkeologjike kryhen në bazë të lejes nga Drejtoria”.

Në paragrafin (2) i cili bëhet paragraf (3), numri “(1)” zëvendësohet me numrin “(2)”, ndërsa fjala “përcaktohet” zëvendësohet me fjalën “konfirmohet”, ndërsa pas fjalëve: “bartësi i lejes” shtohen fjalët: “udhëheqësi profesional për hulumtime arkeologjike”.

Në paragrafin (3) dhe (4) që bëhen paragrafë (4) dhe (5), numri “(1)” zëvendësohet me numrin “(2)”.

Në paragrafin (5) i cili bëhet paragrafi (6), numri “(4)” zëvendësohet me numrin “(5)”.

Neni 9

Në nenin 56, paragrafi (1) ndryshon si vijon:

“Bartës i lejes për hulumtime arkeologjike, mund të jetë personi vendas fizik ose juridik, që i plotëson kushtet për aftësi profesionale, për kryerjen e llojit përkatës të hulumtimeve arkeologjike, dhe i plotëson kushtet e tjera për marrjen e lejes. Me përjashtim, të përcaktuar në nenin 57 paragrafi (2) të këtij ligji, bartës i lejes mund të jetë personi i huaj juridik”.

Në paragrafin (2) pika 3, fjalët: “një hulumtues të autorizuar”, zëvendësohen me fjalët: “një person profesional me statusin e udhëheqësit profesional për hulumtime arkeologjike”.

Në paragrafin (2) pika 4, fjalët: “hulumtuesit të autorizuar”, zëvendësohen me fjalët: “udhëheqësit profesional për hulumtime arkeologjike”.

Në paragrafin (3) fjalët: “hulumtuesit të autorizuar”, zëvendësohen me fjalët: “udhëheqësit profesional për hulumtime arkeologjike”.

Paragrafi (4), ndryshon si vijon:

“Udhëheqës profesional për hulumtime arkeologjike (në tekstin e mëtejshëm: “udhëheqës profesional”) sipas paragrafit (2) pikat 3 dhe 4 dhe paragrafit (3) të këtij neni, konsiderohet personi që ka përgatitje sipërore profesionale, historian i diplomuar i artit me arkeologji dhe arkeolog i diplomuar, përvojë të evidentuar në organizimin e hulumtimeve dhe së paku 12 muaj përvojë të evidentuar, të fituar në pjesëmarrjen e hulumtimeve të terrenit pas diplomimit. Udhëheqës profesional mund të jetë vetëm shtetasi i Republikës së Maqedonisë.

Paragrafi (5), ndryshon si vijon:

“Drejtoria për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, gjatë dhënies së lejes për hulumtime arkeologjike, konfirmon nëse personi që është paraqitur për udhëheqës profesional, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 56 paragrafi (4) të këtij ligji.”

Paragrafët (6) dhe (7) fshihen.

Neni 10

Neni 57 paragrafi (1), ndryshon si vijon:

“Organizatata ndërkombëtare nga sfera për mbrojtjen, institucionet e huaja shkencore dhe punëtorët e veçantë të huaj nga sfera e arkeologjisë, mund të marrin pjesë në hulumtimet arkeologjike, vetëm nëse punët i kryejnë në bashkëpunim me personat juridikë nga neni 56 paragrafi (2) pikat 1 dhe 2, dhe në kushtet e përcaktuara me marrëveshjen e lidhur ndërmjet tyre.”

Në paragrafin (5) fjalët: “udhëheqësin e hulumtimeve” zëvendësohen me fjalët: “udhëheqësin profesional”.

Neni 11

Në nenin 58 paragrafi (1) pika 1, pas numrit “57”, shtohen fjalët: “paragrafit (2) dhe (3)”.

Në pikën 2 fjalët: “planin themelor” zëvendësohet me fjalën “programin”.

Pika 3, ndryshon si vijon:

“Të dhënat për personat profesionalë, që marrin pjesë në hulumtim”.

Pas paragrafit (1), shtohet paragrafi i ri (2), si vijon:

“(2) Nëse bartësi i lejes dhe udhëheqësi profesional janë persona të ndryshëm, dorëzohet edhe marrëveshja për rregullimin e të drejtave dhe obligimeve të tyre.”

Në paragrafin (2) i cili bëhet paragraf (3), në fund të fjalisë pas fjalës “hulumtimet”, shtohen fjalët: “me të cilën rregullohet ruajtja e përkohshme e të dhënave deri në dorëzimin e tyre në institucionin kompetent muzeor, nga neni 61 paragrafët (1), (2) dhe (6) të këtij ligji.

Në paragrafin (3), i cili bëhet paragraf (4), fjala “marrëveshje” zëvendësohet me fjalën “dokument”.

Paragrafi (4) bëhet paragraf (5).

Neni 12

Në titullin e neni 59 pas fjalëve: “bartësit të lejes” shtohen fjalët: “dhe udhëheqësit profesional”.

Në nenin 59 paragrafi (1), fjalët: “bartësi i lejes” zëvendësohen me fjalët: “udhëheqësi profesional”.

Në paragrafin (1) pas pikës 4, shtohen katër pika të reja 5, 6, 7 dhe 8, si vijojnë:

“5. t’i kryejë gërmimet arkeologjike, në pajtim me lejen e lëshuar”,

6. të zbatojë metodologji përkatëse,

7. të ketë kujdes që të mos shkaktojë dëm, ose të shkaktojë rrezik të drejtpërdrejtë për dëmtimin ose shkatërrimin e gërmimeve, dhe

8. të veprojë në pajtim me normat etike, në sferën e mbrojtjes.”

Pikat 5 dhe 6, bëhen pika 9 dhe 10.

Në paragrafin (2) pas fjalës “hulumtime”, shtohen fjalët: “me propozimin e udhëheqësit profesional”.

Në paragrafin (2) pika 2, fjalët: “nuk konservohet, përkatësisht prezantohet” zëvendësohen me fjalët: “sipas rezultateve të gërmimeve nuk do të jetë lëndë e konservimit përkatësisht prezantimit të mëtejme”.

Në paragrafin (3) pas fjalës “hulumtime” shtohen fjalët: “dhe udhëheqësi profesional”, ndërsa fjalët: “është i obliguar”, zëvendësohen me fjalët: “janë të obliguar”.

Në pikën 1 fjala “paraqesë” zëvendësohen me fjalën “paraqesin”.

Pika 2, ndryshon si vijon:

“Në afat prej një viti, në Drejtori ta dorëzojnë ekzemplarën e dokumentacionit nga gërmimet e kryera arkeologjike”.

Në pikën 3 dhe 4 fjala “paraqesë” zëvendësohet me fjalën “paraqesin”.

Neni 13

Në nenin 60 paragrafi (1), pas fjalëve: “nëse bartësi i lejes”, shtohen fjalët: “ose udhëheqësi profesional”.

Paragrafi (2) ndryshon, si vijon:

“Nëse në afatin nga paragrafi (1) i këtij neni, bartësi i lejes ose udhëheqësi profesional nuk i plotëson kushtet për vazhdimin e hulumtimeve arkeologjike, si dhe në rast të rrezikut të drejtpërdrejtë për gërmimet, Drejtoria me aktvendim do ta heqë lejen e lëshuar.”

Neni 14

Në nenin 61 paragrafi (6) pas fjalëve: “janë kryer hulumtime”, shtohen fjalët: “ose në institucion tjetër publik muzeor”.

Neni 15

Në nenin 62 paragrafi (2) pika 3, fjalët: “udhëheqësi i hulumtimeve” zëvendësohen me fjalët: “udhëheqësi profesional”.

Neni 16

Në nenin 70 paragrafi (4), ndryshon si vijon:

“Nëse për të mirën e caktuar të patundshme, nuk është miratuar akt për mbrojtje, e për të cilën ekzistojnë predispozita të bazuara se duhet të miratohet akti për mbrojtje, përkatësisht akti për mbrojtje është në procedurën e miratimit, miratuesi i planit mund të bëjë ndryshimin e planit, dhe të përcaktojë regjim tjetër të rregullimit hapësinor, nëse në afat prej një viti organi kompetent nuk e miraton aktin për mbrojtje.”

Neni 17

Në nenin 74 paragrafi (1) pas fjalëve: “akti sipas ligjit”, shtohen fjalët: “ose në plan nuk janë inkorporuar bazat për mbrojtje-konservim”.

Pas paragrafit (2) shtohet paragrafi i ri (3), si vijon:

“(3”) Kushtet për mbrojtje konservim nga paragrafi (1) i këtij neni, paraqesin bazë për përpilimin e projektit ideor”.

Paragrafët (3) dhe (4) bëhen paragrafë (4) dhe (5).

Në paragrafin (5) i cili bëhet paragrafi (6), numri “(4)” zëvendësohet me numrin “(5)”.

Neni 18

Titulli i nenit 75 “Pajtimi dhe mendimi për mbrojtje konservim” ndryshon si vijon: “Leja paraprake për mbrojtje konservim”.

Në nenin 75 paragrafi (1) fjalët: “jep pëlqim për mbrojtje-konservim, në dokumentacionin e projektit dhe dokumentacionin tjetër teknik”, zëvendësohen me fjalët: “lëshon leje paraprake për mbrojtje-konservim”.

Paragrafi (2) fshihet.

Në paragrafin (3) që bëhet paragraf (2), fjalët: “Pëlqimi nga paragrafi (1) dhe mendimi nga paragrafi (2)” zëvendësohen me fjalët: “Leja paraprake për mbrojtje-konservim nga paragrafi (1) i këtij neni”.

Në paragrafin (4) që bëhet paragraf (3), numri “(3)”, zëvendësohet me numrin “(2)”, ndërsa fjala “pajtimit” zëvendësohet me fjalët: “Lejes paraprake për mbrojtje konservim”.

Neni 19

Në nenin 85 paragrafi (3) fjala “kryesor” zëvendësohet me fjalët: “ideor dhe themelor”.

Paragrafi (4), ndryshon si vijon:

“Projekti ideor përpilohet detyrimisht, në pajtim me dispozitat e përgjithshme për projektimin e objekteve.”

Neni 20

Në nenin 96 paragrafi (1) pas fjalëve: “e mira”, vihet presje dhe shtohen fjalët: “duke përfshirë edhe pasurinë nacionale”, ndërsa fjala “pëlqim” zëvendësohet, me fjalën “leje”.

Në paragrafin (2) fjala “Pëlqim” zëvendësohet me fjalën “Leje”, ndërsa në fjalinë e dytë të paragrafit të njëjtë, fjala “Pëlqimi” zëvendësohet me fjalën “Leja” dhe pas fjalës “kërkesës” shtohen fjalët: “në formular të përcaktuar”.

Në paragrafin (3) pas pikës në fund të fjalisë, shtohet fjalia e re, si vijon: “Sipas nevojës me kërkesën e Drejtorisë, parashtruesi i kërkesës është i obliguar që ta mundësojë prezantimin fizik të së mirës që duhet të nxirret”.

Në paragrafin (4) fjala “pëlqimin” zëvendësohet me fjalën “lejen”.

Pas paragrafit 4, shtohet paragrafi i ri (5), si vijon:

“(5) Leja nga paragrafi (1) i këtij neni, lëshohet në formular të përcaktuar, dhe si:

1. Leje standarde për nxjerrje, për send të veçantë ose grup sendesh, që vazhdon në afatin e përcaktuar në lejen në fjalë, por jo më gjatë se 12 muaj nga dita e lëshimit;

2. Leje e hapur speciale për nxjerrje, për nxjerrje të shumëfishtë të sendit të caktuar, pronari apo poseduesi tjetër i të cilit, do ta shfrytëzojë ose ekspozojë sendin e atillë, me afat të vlefshmërisë, më së shumti pesë vjet nga dita e lëshimit;

3. Leje e përgjithshme e hapur për nxjerrje, për sende që janë pjesë e përmbledhjes publike, me afat vlefshmërie më së shumti pesë vjet nga dita e lëshimit”.

Në paragrafin (5) që bëhet paragraf (6), fjala “pëlqimit” zëvendësohet me fjalën “lejes”.

Paragrafi (6) bëhet paragraf (7).

Neni 21

Në nenin 97 paragrafi (1) pas presjes, para fjalës “mundet”, shtohet fjalët: “me përjashtim të asaj që paraqet pasuri nacionale”, ndërsa fjala “pëlqimit” zëvendësohet, me fjalën “lejes”.

Në paragrafin (2) fjala “Pëlqim” zëvendësohet me fjalën “Leje”.

Në paragrafin (3) pika 2 fjala “pëlqim” zëvendësohet me fjalën “leje”.

Pas paragrafit (3) shtohet paragrafi i ri (4), si vijon:

“(4) Leja nga paragrafi (1) i këtij neni, lëshohet në formular të përcaktuar dhe ka vlefshmëri së paku dymbëdhjetë muaj nga dita e lëshimit. Nëse afati kalon pa qenë e shfrytëzuar, bartësi i lejes është i detyruar që të njëjtën t’ia kthejë organit që e ka lëshuar”.

Paragrafi (4) bëhet paragraf (5).

Në paragrafin (5) që bëhet paragraf (6), numri “(4)”, zëvendësohet me numrin “(5)”, ndërsa pas fjalës “eksportit” shtohen fjalët: “nuk paraqet pasuri nacionale dhe”.

Në paragrafin (6) që bëhet paragraf (7), numri “(4)”, zëvendësohet me numrin “(5)”, ndërsa fjalët: “mbrojtje të përkohshme” zëvendësohen me fjalët: “përcaktimin e pasurisë nacionale”.

Në paragrafin (7) që bëhet paragraf (8), numrat “(4), (5) dhe (6)” zëvendësohen me numrat “(5), (6) dhe (7)”.

Paragrafi (8) bëhet paragraf (9).

Neni 22

Pas nenit 97 shtohet neni i ri 97 – a, si vijon:

“Dispozita të veçanta”

Neni 97-a

(1) Lejet dhe certifikatat për nxjerrje dhe eksport nga nenet 96 paragrafi (1) dhe 97 paragrafi (1), (5) dhe (8) të këtij ligji, lëshohen dhe shfrytëzohen në pajtim me këtë ligj dhe dispozitat e Unionit Evropian.

(2) Formën dhe përmbajtjen e formularëve të lejeve dhe certifikatave nga paragrafi (1) i këtij neni, dhe mënyrën e lëshimit të lejeve dhe certifikatave, i përcakton ministri i Kulturës.

(3) Përdorimi i lejeve dhe certifikatave nga paragrafi (1) i këtij neni, nuk ka ndikim ndaj obligimeve të lidhura me procedurat doganore për eksport ose dokumentet përcjellëse.

(4) Shpenzimet lidhur me kërkesat (lutjet), për lëshimin e lejeve dhe certifikatave nga paragrafi (1) i këtij neni, i bart parashtruesi i kërkesës.”

Neni 23

Në nenin 98 paragrafi (1), fjalët: “pëlqim të lëshuar” zëvendësohen me fjalët: “leje të lëshuar”.

Neni 24

Në nenin 100 paragrafi (2) pika 2, pas presjes para fjalëve: “në pajtim” shtohen fjalët: “përkatësisht padi në gjyqet kompetente të shteteve të tjera”.

Në paragrafin (4) pas fjalës “pika” shtohen numri “1 dhe”.

Në paragrafin (5) pas presjes, para fjalëve: “duke llogaritur” shtohen fjalët: “në vendin dhe prej vendit anëtar të Unionit Evropian, përkatësisht në afatin prej tre vjetësh, në vendin dhe prej vendit tjetër.

Në paragrafin (5) pika 1 pas fjalës “vjet” shtohen fjalët: “në vendin dhe prej vendit anëtar të Unionit Evropian, përkatësisht 50 vjet, në vendin dhe prej vendit tjetër, duke llogaritur”.

Në paragrafin (5) pika 2 pas fjalës “publike” shtohen fjalët: “ose sakrale”, ndërsa në fund pika zëvendësohet me presje dhe shtohen fjalët: “përveç në vendet ku procedurat nuk i nënshtrohen afatit kohor, ose me marrëveshje bilaterale është përcaktuar afati më i gjatë se 75 vjet”.

Neni 25

Pas nenit 100 shtohen tre nene të reja 100-a, 100-b dhe 100-v, si vijojnë:

“Kthimi i të mirave të eksportuara në mënyrë të paligjshme nga territori i Republikës së Maqedonisë, që gjenden në territorin e vendit anëtar të Unionit Evropian

Neni 100-a

(1) Dispozitat nga neni 100 të këtij ligji në mënyrë përkatëse zbatohen në kthimin e të mirave të eksportuara në mënyrë të paligjshme nga territori i Republikës së Maqedonisë, që gjenden në territorin e vendit - anëtar të Unionit Evropian, nëse me këtë apo tjetër ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

(2) Republika e Maqedonisë nga vendi - anëtar i Unionit Evropian mund të kërkojë kthimin e të mirave të eksportuara në mënyrë të paligjshme, e cila:

1) para ose pas mënjanimit të saj ligjor nga territori i Republikës së Maqedonisë është e mbrojtur si pasuri nacionale, dhe e cila

2) i takon njërit prej llojeve të të mirave nga neni 32-a paragrafi 1 i këtij ligji ose nuk u takon atyre, por paraqet pjesë përbërëse të:

- përmbledhjes publike të regjistruar në librin e inventarit të institucionit publik të muzeut, kinotekës ose Arkivit, dhe

- pajisjes ose përmbledhjes së bashkësisë fetare.

(3) Vendim për ngritjen e procedurës për kthimin e të mirave nga paragrafi (2) të këtij neni, merr ministri i Kulturës dhe së bashku me dokumentacionin gjithëpërfshirës (dosjen) ia dërgon Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë.

(4) Procedura për kthimin e të mirave të eksportuara në mënyrë të paligjshme ngrihet drejtpërsëdrejti para gjykatës kompetente të vendit - anëtar të Unionit Evropian, me parashtrimin e padisë përkatësisht propozimit kundër personit që e zotëron, me bashkëngjitjen e:

1) dokumentit në të cilin është dhënë përshkrim i detajuar dhe të dhënat për identifikimin e të mirës kthimi i së cilës kërkohet;

2) deklaratën nga Ministria e Kulturës se bëhet fjalë për të mirën e mbrojtur; dhe

3) deklaratën nga Drejtoria për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore se bëhet fjalë për të mirën e eksportuar në mënyrë të paligjshme.

(5) Ministria e Kulturës është e detyruar që për procedurën e ngritur gjyqësore menjëherë ta njoftojë organin qendror për koordinim të restitucionit të vendit - anëtar të Unionit Evropian nga i cili kërkohet kthimi i të mirës.

Kthimi i të mirave të eksportuara në mënyrë të paligjshme nga vendi - anëtar i Unionit Evropian që gjenden në territorin e Republikës së Maqedonisë

Neni 100-b

(1) Dispozitat nga neni 100 të këtij ligji në mënyrë përkatëse zbatohen për kthimin e të mirave të eksportuara në mënyrë kundërligjore nga territori i vendit - anëtar i Unionit Evropian që gjenden në territorin e Republikës së Maqedonisë, nëse me këtë apo ligj tjetër nuk është përcaktuar ndryshe.

(2) Vendi - anëtar i Unionit Evropian në procedurën e përcaktuar me këtë ligj mund të kërkojë kthimin e të mirës së eksportuar në mënyrë të paligjshme, e cila gjendet në territorin e Republikës së Maqedonisë, e cila:

1) para ose pas mënjanimit të saj kundërligjor nga territori i saj është e mbrojtur si pasuri nacionale me vlerë artistike, historike ose arkeologjike, e cila

2) bën pjesë në njërën nga llojet e të mirave të parapara në Aneksin e Direktivës së Këshillit 93/7/BEE nga 15 marsi 1993 për kthimin e të mirave kulturore të marra nga territori i vendit - anëtar ose nuk u përket atyre por paraqet pjesë përbërëse të:

- përmbledhjes publike me të cilën administrojnë muzetë, bibliotekat ose arkivat e vendit - anëtar; dhe

inventarëve të shoqërive fetare të vendit - anëtar.

(3) Vendi - anëtar Ministrisë së Kulturës së Republikës së Maqedonisë mund t'i paraqesë kërkesë për gjetjen e të mirave të caktuara nga paragrafi (2) të këtij neni dhe për përcaktimin e identitetit të personit i cili e posedon të mirën e kërkuar. Pas pranimit të kërkesës së atillë Ministria e Kulturës vepron në kuptimin e nenit 100 paragrafi (3) të këtij ligji.

(4) Procedura për kthimin e të mirës nga paragrafi (2) të këtij neni ngrihet drejtpërsëdrejti para gjykatës kompetente, me parashtrimin e propozimit dhe të dëshmive të nevojshme nga neni 100 paragrafi (7) të këtij ligji.

(5) Pas pranimit të njoftimit për ngritjen e procedurës, Ministria e Kulturës së Republikës së Maqedonisë për atë i lajmëron organet qendrore për koordinim të restitucionit të vendeve tjera - anëtare të Unionit Evropian.

(6) Gjykata kompetente do të urdhërojë kthimin e të mirës së kërkuar, nëse vërteton se:

1) propozimi është paraqitur në afatin nga neni 100 paragrafi 5 të këtij ligji;

2) bëhet fjalë për të mirën nga paragrafi 2 i këtij neni;

3) ajo është eksportuar në mënyrë të paligjshme nga territori i vendit - anëtar; dhe

4) eksporti kundërligjor ka qenë i kryer pas afatit nga neni 100-v paragrafi (2) i këtij ligji.

(7) Me vendimin me të cilin pranohet propozimi për kthimin gjykata vendos dhe për dëmshpërblimin e poseduesit të së mirës së kërkuar.

(8) Dëmshpërblimin në para nga paragrafi (7) të këtij neni vendi - anëtar e deponon në gjykatë dhe e njëjta do t'i dërgohet kundërshtarit në procedurën kur nga Ministria e Kulturës së Republikës së Maqedonisë gjykata do të marrë njoftim se e mira e kërkuar i është dorëzuar vendit - anëtar.

(9) Kundërshtari në procedurë është i detyruar që të mirën e kërkuar ta dorëzojë në afat prej tri ditësh pas deponimit të shumës për dëmshpërblim në para nga paragrafi (8) të këtij neni.

Dispozita të veçanta

Neni 100-v

(1) E mirë e eksportuar në mënyrë kundërligjore në kuptimin e neneve 100, 100-a dhe 100-b të këtij ligji llogaritet e mira, e cila:

1) nga territori i Republikës së Maqedonisë, përkatësisht vendi -anëtar i Unionit Evropian është çuar në kundërshtim me dispozitat e tij për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, përkatësisht në kundërshtim me rregullat e Unionit Evropian për eksportin e të mirave kulturore; dhe

2) nuk është kthyer deri në skadimin e afatit të përcaktuar për nxjerrjen, përkatësisht eksportin e përkohshëm.

(2) Kthim në kuptimin e neneve 100-a dhe 100-b të këtij ligji, mundet të kërkohet për të mirë që është nxjerrë në mënyrë kundërligjore nga territori i Republikës së Maqedonisë, përkatësisht vendi - anëtar i Unionit Evropian pas 31.12.1992.

(3) Procedurat për restitucion, përkatësisht për kthimin në bazë të dispozitave të këtij ligji nuk ndikojnë mbi procedurat civile ose penale që mundet të ngrihen nga ana e shtetit të interesuar ose pronarit, përkatësisht zotëruesit të së mirës së vjedhur të eksportuar në mënyrë kundërligjore.

(4) Dispozitat nga nenet 100-a dhe 100-b të këtij ligji në mënyrë përkatëse zbatohen dhe në raport me restitucionin, përkatësisht kthimin e të mirave të mbrojtura nga dhe ndaj vendeve që nuk janë anëtare të Unionit Evropian, nëse nuk janë në kundërshtim me afatet dhe kushtet e tjera nga neni 100 të këtij ligji.

Neni 26

Në nenin 153 paragrafi (1), paragrafi (2) pika 1, 2, 3, 6, 7, 8, 9 dhe 10 paragrafi (3) pika 3 fjala "kinotekës" zëvendësohet me fjalën "audio-vizual".

Neni 27

Në nenin 163 pika 3 fjalët: „veprimtari kinoteke” zëvendësohen me fjalët: "veprimtaria për mbrojtjen e të mirave audio-vizuale".

Neni 28

Titulli i Kreut "Dispozita ndëshkuese" zëvendësohet me titullin "Dispozita për kundërvajtje"

Në nenin 172 paragrafi (1) fjalia hyrëse ndryshohet si vijon: Gjobë në shumë prej 6000 deri në 8 000 euro me kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet për kundërvajtje personit juridik që: ".
Në nenin 1, numri "(1)" zëvendësohet me numrin "(2)".

Pika 3 ndryshohet si vijon:

"Nuk fiton leje paraprake mbrojtëse konservatore të projektit ideor për trashëgimi të palëvizshme kulturore.

Paragrafët (2), (3), (4) dhe (5) ndryshohen si vijojnë:

"(2) Gjobë në shumë prej 1 500 deri në 2 000 euro me kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni edhe personit përgjegjës në personin juridik"

(3) Gjobë në shumë prej 3 000 deri në 4 000 euro me kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet për kundërvajtje nga paragrafi 1 pikat 1, 2, 3, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16 dhe 17 të këtij ligji edhe tregtarit individ.

(4) Gjobë në shumë prej 800 deri në 1 000 euro me kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet për kundërvajtje nga paragrafi 1 pikat 1, 2, 3, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16 dhe 17 të këtij ligji edhe personit fizik".

(5) 'Për kundërvajtjen nga paragrafi (1) pikat 2, 5, 9, 10, 11, 12 dhe 13 të këtij neni personit juridik mundet t'i kumtohet masë e veçantë për kundërvajtje konfiskim i sendeve që paraqesin të mirë të mbrojtur të lëvizshme e cila është fituar me kryerjen e kundërvajtjes."

Pas paragrafit (5), shtohet paragrafi i ri (6) si vijon:

"(6) Për kundërvajtjen nga paragrafi (1) pikat 2, 5, 9, 10, 11, 12 dhe 13 të këtij neni personit fizik mundet t'i kumtohet masë e veçantë për kundërvajtje konfiskim i sendeve që paraqesin të mirë të mbrojtur të lëvizshme e cila është fituar me kryerjen e kundërvajtjes."

Paragrafi (6), i cili bëhet paragraf (7), ndryshohet si vijon:

"(7) Për kundërvajtjen nga paragrafi (1) pikat 1, 3, 4, 6, 7, 8 dhe 14 të këtij neni personin juridik mundet t'i kumtohet sanksion ndalesë e përkohshme për kryerjen e veprimtarisë së caktuar në kohëzgjatje prej gjashtë muaj deri në dy vjet."

Neni 29

Në nenin 173 paragrafi (1) fjalia hyrëse ndryshohet si vijon: "Gjobë në shumë prej 4 000 deri në 5 000 euro me kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet për kundërvajtje personit juridik që:

Pikat 1, 2, 3 dhe 4 shlyhen.

Pikat 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30 dhe 31 bëhen pika 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26 dhe 27.

Paragrafët (2), (3), (4) dhe (5) ndryshohen si vijon:

"(2) Gjobë në shumë prej 1 000 deri në 1 500 euro me kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni edhe personit përgjegjës në personin juridik.

(3) Gjobë në shumë prej 1 500 deri në 3 000 euro me kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni edhe tregtarit individual.

(4) Gjobë në shumë prej 500 deri në 700 euro me kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni edhe personit fizik.

(5) Për kundërvajtjet nga paragrafi (1) pikat 9, 17, 19, 21, 22 të këtij neni personit juridik mundet t'i kumtohet masë e veçantë për kundërvajtje konfiskim i sendeve që paraqesin të mirë të mbrojtur të lëvizshme e cila është fituar me kryerjen e kundërvajtjes."

Pas paragrafit (5), shtohet paragrafi i ri 6, si vijon:

“(6) Për kundërvajtjen nga paragrafi (1) pikat 9, 17, 19, 21, 22 të këtij neni personit fizik mundet t'i kumtohet masë e veçantë për kundërvajtje konfiskim i sendeve që paraqesin të mirë të mbrojtur të lëvizshme e cila është fituar me kryerjen e kundërvajtjes.”

Paragrafi (6), i cili bëhet paragraf (7), ndryshohet si vijon:

“(7) Për kundërvajtjen nga paragrafi (1) pikat 1, 2, 3, 4, 5, 8, 9, 10, 11, 12, 14, 16, 17, 19 dhe 20 personit juridik mundet t'i kumtohet sanksion ndalesë e përkohshme për kryerjen e veprimtarisë së caktuar në kohëzgjatje prej gjashtë muaj deri në dy vjet.”

Neni 30

Pas nenit 173 shtohet neni i ri 173-a, si vijon:

“Neni 173-a

(1) Gjobë në shumë prej 500 deri në 700 euro me kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet për kundërvajtje edhe personit fizik që:

1) nuk mban dokumentacion të rregullt dhe evidencë për hulumtimet arkeologjike dhe masat për mbrojtje që i ndërmerr (neni 59 paragrafi (1) pika 1),

2) nuk siguron ruajtjen dhe mirëmbajtjen e vendzbulimit arkeologjik dhe gjetjet (neni 59 paragrafi (1) pika 2);

3) nuk ndërmerr masa përkatëse dhe gjetjet i lë të zbuluara ose ekspozuara gjatë gjurmimeve arkeologjike (neni 59 paragrafi 1 pika 3);

4) nuk ushtron ose organizon kryerjen e punëve konservatore në vendzbulimin ose gjetjet për kohën e hulumtimeve (neni 59 paragrafi (1) pika 4);

5) nuk i kryen gjurmimet arkeologjike në pajtim me lejen e lëshuar (neni 59 paragrafi (1) pika 5);

6) gjatë gjurmimeve arkeologjike nuk zbaton metodologji përkatëse (neni 59 paragrafi (1) pika 6); dhe

7) shkakton dëm ose shkakton rrezik për dëmtimin ose shkatërrimin e gërmimeve (neni 59 paragrafi (1) pika 7).

(2) Për kundërvajtjen nga paragrafi (1) të këtij neni personit fizik mundet t'i kumtohet masë e veçantë për kundërvajtje konfiskim i sendeve që paraqesin të mirë të mbrojtur të lëvizshme e cila është e fituar me kryerjen e kundërvajtjes.”

(3) Për kundërvajtjen nga paragrafi (1) personit fizik mundet t'i kumtohet sanksion ndalesë për kryerjen e veprimtarisë së caktuar në kohëzgjatje prej gjashtë muaj deri në dy vjet.

Neni 31

Në nenin 174 paragrafi 1 fjalia hyrëse ndryshohet si vijon: “Gjobë në shumë prej 2000 euro me kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet për kundërvajtje personit juridik që:”.

Në nenin 5 pas fjalës “pikë” numri “(5)” zëvendësohet me numrin “(9)”.

Në nenin 6 pas fjalës “pikë” numri “(6)” zëvendësohet me numrin “(10)”.

Paragrafët (2), (3), (4) dhe (5) ndryshohen si vijon:

“(2) Gjobë në shumë prej 1 000 euro me kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni edhe personit përgjegjës në personin juridik”.

(3) Gjobë në shumë prej 1 300 me kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet për kundërvajtje nga paragrafi 1 pikat 8, 9, 10, 11 dhe 18 të këtij neni edhe tregtarit - individ.

(4) Gjobë në shumë prej 500 euro me kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) pikat 5, 6, 7, 8, 9, 10 dhe 18 të këtij neni edhe personit fizik.

(5) Për kundërvajtjen nga paragrafi (1) pikat 8, 9 dhe 11 të këtij neni personit juridik mundet t'i kumtohet masë e veçantë për kundërvajtje konfiskim i sendeve që paraqesin të mirë të mbrojtur të lëvizshme e cila është fituar me kryerjen e kundërvajtjes.”

Pas paragrafit (5), shtohet paragrafi i ri (6), si vijon:

"(6) Për kundërvajtjen nga paragrafi (1) pikat 8, 9 dhe 11 të këtij neni personit fizik mundet t'i kumtohet masë e veçantë për kundërvajtje konfiskim i sendeve që paraqesin të mirë të mbrojtur të lëvizshme e cila është fituar me kryerjen e kundërvajtjes.

Neni 32

Pas nenit 174 shtohen katër nene të reja 174-a, 174-b, 174-v dhe 174-g si vijojnë:

"Kompetencat e gjykatës

Neni 174-a

Për kundërvajtjet nga neni 172, 173 dhe 173-a të këtij neni procedurën për kundërvajtje e mban dhe sanksion për kundërvajtje kumton gjykata kompetente.

Organi për kundërvajtje

Neni 174-b

(1) Për kundërvajtjet e përcaktuara në nenin 174 të këtij ligji, procedurë për kundërvajtje mban dhe sanksion për kundërvajtje kumton organi i administratës shtetërore kompetente për punët nga sfera e kulturës (në tekstin e më tutjeshëm: Organi për kundërvajtje).

(2) Procedurën për kundërvajtje nga paragrafi (1) të këtij neni para organit për kundërvajtje e mban Komisioni për vendosje ndaj kundërvajtjes (në tekstin e më tutjeshëm: Komisioni për kundërvajtje) i formuar nga ana e ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetente për kryerjen e punëve nga sfera e kulturës.

(3) Komisioni për kundërvajtje përbëhet nga persona të autorizuar zyrtarë të punësuar në organin e administratës shtetërore kompetente për kryerjen e punës në sferën e kulturës, prej të cilëve njëri e kryen funksionin e kryetarit të Komisionit për kundërvajtje.

(4) Komisioni për kundërvajtje përbëhet nga tre anëtarë nga të cilët:

- dy juristë të diplomuar, nga të cilët njëri me provim të dhënë të jurisprudencës me pesë vjet përvojë pune në sferën e tij, dhe

- një anëtar me përgatitje të lartë profesionale nga sfera e shkencave shoqërore me pesë vjet përvojë pune në sferën e tij.

(5) Komisioni për kundërvajtje zgjidhet në kohëzgjatje prej tre vjetësh me të drejtë rizgjedhje të anëtarëve.

(6) Për kryetar të Komisionit për kundërvajtje mundet të zgjidhet vetëm juristi i diplomuar.

(7) Komisioni për kundërvajtje për Organin për kundërvajtje vendos për kundërvajtjet e përcaktuara me këtë apo ligj tjetër dhe kumton sanksione për kundërvajtje të përcaktuara me këtë ligj, Ligjin për kundërvajtjet dhe/ose me ligj tjetër.

(8) Përveç anëtarëve të Komisionit për kundërvajtje ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e kulturës mundet të caktojë sekretar të Komisionit për kundërvajtje i cili kryen punë administrative për komisionin dhe zëvendës-anëtarë, të cilët me përjashtim, marrin pjesë në punën e Komisionit për kundërvajtje në rast të mungesës së ndonjërit prej anëtarëve.

(9) Komisioni për kundërvajtje miraton rregullore për punën e vet .

(10) Kundër aktvendimeve të Komisionit për kundërvajtje, për të cilat kumtohet sanksion për kundërvajtje mundet të parashtrohet aktpadi për ngritjen e kontestit administrativ para gjykatës kompetente.

Puna e Komisionit për kundërvajtje

Neni 174-v

(1) Anëtari i Komisionit për kundërvajtje mundet të shkarkohet:

- 1) me skadimin e afatit për të cilin është emëruar si anëtar;
 - 2) me kërkesë të tij;
 - 3) me plotësimin e kushteve për pension pleqërie në pajtim me ligjin;
 - 4) nëse i vërtetohet paaftësi e përhershme;
 - 5) nëse vërtetohet shkelja e dispozitave për mbajtjen e procedurës për kundërvajtje me vendim të plotfuqishëm;
 - 6) nëse vërtetohet shkelja e dispozitave për mbajtjen e procedurës për kundërvajtje me vendim të plotfuqishëm;
 - 7) nëse nuk i plotëson kushtet, obligimet të cilat dalin nga puna në Komisionin për kundërvajtje; dhe
 - 8) nëse nuk ka lajmëruar ekzistimin e konfliktit të interesave për rast për të cilin vendos Komisioni për kundërvajtje.
- (2) Propozim për shkarkim të anëtarit të komisionit për rastet nga paragrafi (1) pikat prej 3 deri në 8 të këtij neni i parashtron kryetari i Komisionit për kundërvajtje ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e kulturës.
- (3) Komisioni për kundërvajtje ka të drejtë të nxjerr dëshmi dhe të grumbullojë të dhëna të cilat janë të domosdoshme për vërtetimin e kundërvajtjes, si dhe të kryejë punë të tjera dhe ndërmarrë veprime të përcaktuara me këtë ligj, Ligjin për kundërvajtje dhe/ose me ligj tjetër.
- (4) Anëtarët e Komisionit për kundërvajtje janë të pavarur dhe të mëvetësishëm në punën e Komisionit për kundërvajtje dhe vendosin në bazë të njohurive të veta profesionale dhe bindjes personale.
- (5) Komisioni për kundërvajtje punon në këshill, ndërsa vendos me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve.
- (6) Komisioni për kundërvajtje mban evidencë unike për kundërvajtjet, sanksionet e kumtuara dhe vendimet e marra.
- (7) Anëtarët e Komisionit për kundërvajtje kanë të drejtë në shpërblim për punën e vet në Komisionin për kundërvajtje me çka e përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punës nga sfera e kulturës e cila doemos duhet të jetë e kuptueshme dhe përkatëse në kuptimin, vëllimin e punës së anëtarëve dhe ndërlikueshmërinë e kundërvajtjeve.

Barazimi

Neni 174-g

- (1) Për kundërvajtjet në nenin 174 të këtij ligji, inspektorët për trashëgimi kulturore, janë të obliguar që kryerësit të kundërvajtjes t'i propozojnë procedurë për barazim, para se të parashtrojnë kërkesë për procedurë për kundërvajtje.
- (2) Kur kryerësi i kundërvajtjes pajtohet për ngritjen e procedurës për barazim, inspektori për trashëgimi kulturore përpilon procesverbalin në të cilin shënohen elementet qenësore të kundërvajtjes, koha, vendi dhe mënyra e kryerjes së kundërvajtjes, përshkrimi i veprimit të kundërvajtjes dhe personat e ndodhur në vendin e ngjarjes.
- (3) Në procesverbal përcaktohet mënyra në të cilën janë mënjeluar pasojat e dëmshme nga kundërvajtja, si dhe mënyra e tejkalimit të pasojave nga kryerja e kundërvajtjes.
- (4) Inspektori për trashëgimi kulturore në procedurën për barazim kryerësit të kundërvajtjes t'i japë urdhër-pagesë.
- (5) Nëse kryerësi e pranon urdhër-pagesën është i detyruar të njëjtën ta nënshkruajë. Pranimi i urdhër-pagesës për kryerësin e kundërvajtjes shënohet në procesverbal.
- (6) Kur si kryerës i kundërvajtjes shfaqet person juridik, procesverbali dhe urdhër-pagesë e nënshkruan në mënyrë zyrtare, përkatësisht personi përgjegjës i cili ka ndodhur në vendin e ngjarjes gjatë mbikëqyrjes së inspektimit ose person tjetër zyrtar ose përgjegjës i cili ka deklaruar se ka të drejtë ta nënshkruajë procesverbalin dhe ta pranojë urdhër-pagesën.

(7) Deklarata nga paragrafi (6) i këtij neni shënohet në procesverbal.

(8) Inspektorët për trashëgimi kulturore janë të detyruar të mbajnë evidencë për procedurat e ngritura për barazim dhe për përfundimin e tyre.

Neni 33

Në nenin 178 paragrafi (1) pikat 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7 ndryshohen si vijon:

“2. Enti për mbrojtjen e monumenteve të kulturës së qytetit të Shkupit vazhdon me punë si Qendër konservuese-Shkup me kompetencë për rajonin e komunave Haračinë, Studeniçan, Petrovec, Ilinden, Sopishtë, Saraj, Çucer-Sandevë, Zelenikovë, Gazi-Babë, Butel, Gjorgje Petrov, Karposh, Kisela Vodë, Aerodrom, Qendër, Çair, Shuto Orizare;

3. Enti për mbrojtjen e monumenteve të kulturës dhe Muzeu Popullor në Ohër, vazhdon me punë si Qendër konservuese - Ohër, me kompetencë për rajonin e komunave Ohër, Debarcë, Strugë dhe Vevčan.

4. Enti për mbrojtjen e monumenteve të kulturës, rariteteve natyrore, muzeve dhe galerive në Manastir, vazhdon me punë si Qendër konservuese - Manastir, me kompetencë për rajonin e komunave Manastir, Novac, Mogilë, Demir Hisar dhe Resnjë.

5. Enti për mbrojtjen e monumenteve të kulturës, rariteteve natyrore dhe muzeve në Prilep vazhdon me punë si Qendër konservuese - Prilep, me kompetencë për rajonin e komunave Prilep, Dolneni, Krivogashtan dhe Krushevë.

6. Enti për mbrojtjen e monumenteve të kulturës, rariteteve natyrore dhe Muzeut Popullor në Shtip vazhdon me punë si Qendër konservuese - Shtip, me kompetencë për rajonin e komunave Shtip, Karbinci, Radovish, Konçe, Sveti Nikollë, Llozovë, Koçanë, Zërnovcë dhe Çeshinovë/Obleshevë.

7. Enti për mbrojtjen e monumenteve të kulturës, rariteteve natyrore dhe muzeve në Strumicë vazhdon me punë si Qendër konservuese - Strumicë, me kompetencë për rajonin e komunave Strumicë, Novo Sellë, Vasilevë, Bosilovë, Valandovë, Gjevgjeli, Bogdancë dhe Dojran.”

Neni 34

Dispozitat miratimi i të cilave është paraparë me këtë ligj, do të miratohet brenda një viti nga dita e hyrjes së këtij ligji në fuqi.

Neni 35

Autorizohet Komisioni ligjdhënës - juridik i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë të përcaktojë tekst të spastruar të Ligjit për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

Neni 36

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e botimit në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.